



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 335, datë 29.07.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT, PËR ZHVILLIMIN E PROCEDIMIT**  
**DISIPLINOR NR.4/2021, TË FILLUAR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**  
**NDAJ MAGJISTRATIT Z. {...}, ME DETYRË GJYQATAR NË GJYKATËN E RRETHIT**  
**GJYQËSOR VLORË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “b” të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të ligjit nr.115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 138 dhe vijues të ligjit nr.96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, me propozim të Kryetarit të Komisionit Disiplinor, z.Medi Bici, pas hedhjes së shortit,

**VENDOSI:**

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, Z. Dritan Hallunaj, në cilësinë e relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor nr.4/2021, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit z.Hektor Sinanaj, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**